



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-011
Prishtinë, më 6 prill 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 PRILL 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës. Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur me 29 mars 2011,
2. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
3. Propozimi i deputetit Nait Hasani për debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë,
4. Kërkesa e z. Kolë Berisha, për realizimin e përfitimeve si ish-zyrtar i lartë,
5. Kërkesa e z. Nexhat Daci, për realizimin e përfitimeve si ish-zyrtar i lartë,
6. Njoftimi me vendimin e deputetëve lidhur me përfaqësimin me rotacion në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në bazë të rotacionit, dhe
7. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me formimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, dhe
8. Njoftimi me Propozim-udhëzimin për administrimin të buxhetit të komisioneve parlamentare.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 mars 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 mars 2011.

2. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet në mbledhjen plenare të radhës, për shqyrtim dhe miratim.

3. Propozimi i deputetit Nait Hasani për debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje nxori, këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesa e deputetit Nait Hasani, për debat parlamentar për gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit do të

radhitet në rendin e ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.

2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme që të përgatitin një informatë lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë dhe Kuvendit t'ia paraqesin këtë informatë, në afatin kohor brenda dy javësh.

4. Kërkesa e ish -kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha, për realizimin e përfitimeve si zyrtar i lartë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha, lidhur me përfitimet si zyrtar i lartë, mori këtë:

V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e ish - kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha, për përfitimet e ish zyrtarit të lartë.

A r s y e t i m

Ish - kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kolë Berisha, ka parashtruar kërkesë për të realizuar përfitimet si ish zyrtar i lartë, më 22 nëntor 2010.

Në bazë të gjendjes faktike, është konstatuar se të njëjtit ushtrimi i funksionit të kryetarit të Kuvendit i ka përfunduar më 9 janar 2008.

Ligji për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë, nr. 03/ L-001, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 qershor 2008, ndërsa ka hyrë ne fuqi më 1 gusht 2008.

Në kohën kur ish kryetarit të Kuvendit i ka pushuar ushtrimi i funksionit të kryetarit të Kuvendit, nuk ka pasur ligj që ka rregulluar këtë çështje.

Ligji për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë, Nr. 03/ L-001, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 qershor 2008, ndërsa ka hyrë ne fuqi më 1 gusht 2008, që do të thotë se ish -kryetarit i ka pushuar ushtrimi i funksionit 7 muaj para hyrjes në fuqi të ligjit.

Dispozitat e Ligjit për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë nuk e kanë rregulluar statusin e ish - zyrtarëve të lartë që e kanë ushtruar funksionin e kryetarit të Kuvendit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përkatësisht dispozitat e ligjit aktual nuk parashohin veprim prapaveprues për përfitimet e ish- zyrtarëve të lartë.

5. Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Nexhat Daci, për realizimin e përfitimeve si zyrtar i lartë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Nexhat Daci, lidhur me përfitimet si zyrtar i lartë, mori këtë:

V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e ish- kryetarit të Kuvendit, z. Nexhat Daci, për përfitimet e ish zyrtarit të lartë.

A r s y e t i m

Ish - kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Nexhat Daci, ka parashtruar kërkesë për të realizuar përfitimet si ish - zyrtar i lartë, më 21 shkurt 2011.

Në bazë të gjendjes faktike, është konstatuar se të njëjtit ushtrimi i funksionit të kryetarit të Kuvendit i ka përfunduar më 10 mars 2006.

Ligji për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë, nr. 03/ L-001, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 qershor 2008, ndërsa ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2008.

Në kohën kur ish kryetarit të Kuvendit i ka pushuar ushtrimi i funksionit të kryetarit të Kuvendit, nuk ka pasur ligj që ka rregulluar këtë çështje.

Ligji për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë, Nr. 03/ L-001, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 qershor 2008, ndërsa ka hyrë ne fuqi më 1 gusht 2008, që do të thotë se ish kryetarit i ka pushuar ushtrimi i funksionit dy vite e gjysmë para hyrjes në fuqi të ligjit.

Dispozitat e Ligjit për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë nuk e kanë rregulluar statusin e ish zyrtarëve të lartë që e kanë ushtruar funksionin e kryetarit të Kuvendit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përkatësisht dispozitat e ligjit aktual nuk parashohin veprim prapaveprues për përfitimet e ish - zyrtarëve të lartë.

6. Njoftimi me vendimin e deputetëve lidhur me përfaqësimin me rotacion në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në bazë të rotacionit

Kryesia e Kuvendit u njoftua lidhur me vendimin e deputetëve të Kuvendit: Danush Ademi, Xhevdet Neziraj dhe Mursel Haljilji, me të cilin janë pajtuar që secili prej tyre të jetë anëtar i Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në bazë të rotacionit.

7. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me formimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit

Komisioni për Legjislacion, në bazë të nenit 70 të Rregullores së Kuvendit, e njofton Kryesinë e Kuvendit lidhur me formimin dhe përbërjen e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit.

8. Njoftimi me Propozim-udhëzimin për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare

Kryesia, lidhur për këtë çështje vendosi që të diskutohet në mbledhjen e radhës dhe pastaj të miratohet një udhëzim për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare.

Pika shitesë:

1. Buxheti i miratuar i Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

Autorizohet sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, që ta zbatojë Buxhetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011, sipas kodeve: 10100-Deputetët e Kuvendit; 10200-Stafi i Administratës së Kuvendit; 15800 - Stafi mbështetës politik dhe kodi 25900-Radio Televizioni i Kosovës, të miratuara me Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:45** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.